

V E N D I M
Nr.57, datë 3.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 3.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.69 Akti që u përket:

KËRKUES: 1. AGRON DUKA, kandidat i pavarur në zonën zgjedhore nr.25, Shijak, përfaqësuar nga avokat Arben Vani, me prokurë.

2. OSMAN METALLA, kandidat i Bashkimit për Fitore, përfaqësuar nga avokat Arben Ristani, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.

2. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.25 SHIJAK, përfaqësuar kryetari Edmond Isaku.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.981, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të mësipërm:

Kërkuesi Agron Duka:

- Të gjitha fletët e votimit të konsideruara të pavlefshme janë të vlefshme në favorin tim.

- Ka manipulime e parregullsi në procesverbal, prandaj duhet organizuar rinumërimi i fletëve të votimit.

2. Kërkuesi Osman Metalla:

- Tabelat e rezultateve për qendrat e votimit nr.8 e 9 Komuna Rrashbull nuk pasqyrojnë të vërtetën e, si rrjedhojë, nuk duhet të përfshihen në rezultatet e zonës. Tabelat e rezultateve në qendrat e votimit nr.6 Komuna Rrashbull dhe nr.8 e 9 Komuna Xhafzotaj janë të rregullta dhe nuk është paraqitur asnjë provë për t'i kundërshtuar ato.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, pretendimet e palëve, administroi provat dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Pas votimit në raundin e parë dhe pas ardhjes së procesverbaleve të komisioneve të qendrave të votimit, Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.25 ka nxjerrë rezultatet dhe i ka pasqyruar në tabelën përmbledhëse të rezultateve. Sipas kësaj table, kërkuesi Agron Duka ka fituar 7 046 vota nga 14 138 vota të vlerësuara të vlefshme në të gjithë zonën, ndërsa kandidati i Bashkimit për Fitore, Osman Metalla, ka fituar 6 716 vota. Asnjëri prej kandidatëve nuk ka fituar shumicën absolute të votave të vlefshme për të dalë fitues, siç përcaktohet në nenin 63/1 të Kodit Zgjedhor.

Në tabelën përmbledhëse, komisioni i zgjedhjeve të zonës ka pasqyruar vërejtjet e të dy përfaqësuesve të kandidatëve. Së pari, të përfaqësuesit të kandidatit Osman Metalla për parregullsi e

shkelje të ligjit në qendrat e votimit nr.8 e 9 Rrashbull dhe së dyti, të përfaqësuesit të kandidatit të pavarur Agron Duka për parregullsi e shkelje të ligjit në qendrat e votimit nr.6 Komuna Rrashbull dhe nr.8 e 9 Komuna Xhafzotaj.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.981, datë 29.6.2001, ka vendosur të mos shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë dhe ka urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve në pesë qendra votimi.

Ky vendim nuk i jep përgjigje pretendimeve të paraqitura në ankesat e kërkesve. Në kërkesat e tyre ka pretendime për manipulime të numrit të votave dhe për nevojën e rinumërimit apo rivotimit edhe në qendra të tjera votimi të asaj zone, për vlerësimin e drejtë të 545 fletëvotimeve të konsideruara të pavlefshme që mund të ndryshojnë krejtësisht rezultatin, në kushtet kur kandidatit Agron Duka i nevojiten vetëm 24 vota për të dalë fitues. Këto probleme nuk mund të gjejnë zgjidhje të drejtë vetëm me rivotimin në pesë qendra votimi prandaj duhet të zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve midis të dy kandidatëve.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.981, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.25.
- Urdhërimin për zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve midis kandidatëve për deputetë Agron Duka, i pavarur dhe Osman Metalla, Bashkimi për Fitore.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.